



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:294241

Datë: 15.04.2022

Numri i dokumentit: 02923598

P.nr.1427/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL e përbërë nga gjyqtari Shabi Idrizi, në lëndën penale kundër të pandehurës A.K nga fshati ...-Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2192-4/19 e datës 19.12.2019., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me dt. 14.04.2022, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Zana Sadiku Sertolli, të pandehurës A.K, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 15.04.2022, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

E pandehura: A.K, e lindur me dt ..., në fshatin ..., nga i ati Sh. dhe e ëma H. e gjinisë I., me vendbanim në fshatin ...Komuna e Ferizajt, ka të kryer shkollën fillore, nënë e 3 (tre) fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, numri personal ... mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se

prej datës se pa vërtetuar e deri me dt.09.09.2019 në shtëpinë e saj në fshatin ... , siguron shërbime për te cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën , në atë mënyre që gatë një kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë ‘‘KEDS’’, rezulton se e pandehura me qellim që të përfitoj në mënyrë të kundërligjshme nga shërbimi , shfrytëzon

energjinë elektrike në mënyre direkt dhe jashtë njehsorit elektrik nr.... dhe i njëjti ka krijuar lidhje të re në rrjetin elektrik, ashtu që ndërmarrjes së dëmtuar ‘‘KEDS’’ Distrikti në Ferizaj, i shkakton dëm në vlerë prej, 193.75 euro.

me të cilën ka kryer veprën penale "vjedhja e shërbimeve " nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar ndëshkimore si dhe neneve: 2, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 72, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453, 463, të KPP-së, te pandehurës A.K i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurës i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Udhëzohet e dëmtuara që kërkesën pasuro-juridike ta realizoj në kontest civil

Obligohet E pandehura që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m i

1.Historiku procedurës dhe aktakuza

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si: PP.II.nr.2192-4/19 e datës 19.12.2019, ndaj të pandehurës A.K nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale sipas nenit 245 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 14.04.2022, dhe pas leximit të aktit akuzues, gjyqtari u bind se e pandehura e ka kuptuar akuzën, komfor nenit 246 par. 4 të pandehurës i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet e pafajshme.

2. Pranimi i fajësisë nga e pandehura

E akuzuara A.K, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është e vetëdijshme për pranimin dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, ndihet thellë e penduar për këtë vepër penale, shpreh keqardhje për këtë, premtion se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, dhe i propozon gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarën, pasi pranimi i fajësisë është bërë në mënyre vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 par 1 të KPPRK si dhe provat materiale të shkresave të lëndës.

3. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par.1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Procesverbalin me nr.2505292, datë: 09.09.2019, raportin e kalkulimit të shpenzimeve të energjisë elektrike Sektori i Rikthimit të humbjeve nr.... datë 10.09.2019 ,fatura e rikthimit të humbjeve DFEHP... ,datë 10.09.2019, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës. Me qenë se e akuzuara ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari komfor nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-

së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në diapozitivin e këtij aktgjykimi, andaj duke marrë parasysh se në veprimet inkriminuese të saj janë përmbushur elementet e veprës e cila i vihet ne barrë, e njëjta është gjetur penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për këtë vepër penale.

4.Caktimi i dënimit për të pandehurën

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarën, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimi gjyqësor e pandehura ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, , gjendja e dobët ekonomike, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkret.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurës, duke marrë parasysh edhe faktin se e njëjta ka bërë pranimin e fajësisë, , duke vlerësuar se edhe me sanksion të posaqshëm penal si vërejtja gjyqësore, me anë të së cilit kryesit i jepet qortim dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, andaj shqiptimi i saj është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht vërejtja e shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

5. shpenzimet procedurale

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil është i marrë në kuptim të nenit 463 të KPPK

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së,

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:294241, 14.04.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.